



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI” REKTORI

Departamenti i **Lëndëve Paraklinike** në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” për nevojat e tij për mbulimin e procesit mësimor, shpall konkurs për **1(një)** personel akademik me kohë të pjesshme të kategorisë “Profesor”, për vitin akademik 2025-2026, semestri i II-të.

Kriteret e përgjithshme për pozicionin e punës për **personel akademik me kohë të pjesshme** të kategorisë “**Profesor**” me profil “**Mjek Dermatolog**”, për konkurrim janë:

1. Kandidati duhet të mbajë të paktën titullin shkencor “Profesor i Asociuar” . (Titulli akademik i lëshuar nga Institucionet e huaja të Arsimit të lartë dhe Institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet të jenë njohur dhe njehsuar paraprakisht nga Ministria e Arsimit dhe Sportit në Shqipëri).
2. Të ketë përfunduar studimet në fushën e kërkuar në përputhje me pozicionin e punës.
3. Të zotërojë me dëshmi së paku një nga 5 (pesë) gjuhët e Bashkimit Evropian (Anglisht, Frëngjisht, Gjermanisht, Italisht, Spanjisht).
4. Ndaj kandidatit të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna.
5. Kandidati duhet të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata.

Kriteret e veçanta për pozicionin e punës për **personel akademik me kohë të pjesshme** të kategorisë “**Profesor**” me profil “**Mjek Dermatolog**”, për konkurrim janë:

1. Kandidati duhet të ketë përfunduar studimet në fushën e “Mjekësisë së Përgjithshme”.
2. Të ketë përfunduar specializimin pasuniversitar në “Dermatologji”, pra të jetë Mjek Specialist “Dermatolog”.
3. Të ketë leje të vlefshme për ushtrimin e profesionit, të lëshuar nga organet kompetente.
4. Të ketë përvojë të dokumentuar profesionale dhe akademike në fushën e “Dermatologjisë”.
5. Preferohet të ketë botime Shkencore kombëtare dhe/ose ndërkombëtare në fushën e “Dermatologjisë”.
6. Të zotërojë aftësi të mira pedagogjike, komunikuese dhe të punës në grup.

Kandidatët **duhet të dorëzojnë** nga data **11.02.2026** deri më **20.02.2026** këto dokumente:

1. Kërkesë me shkrim (Plotësimi i formularit të aplikimit)
2. Jetëshkrimi.
3. Kopje të diplomës dhe të listës së notave. (Diplomat e lëshuara nga Institucionet e huaja të Arsimit të lartë dhe Institucione të tjera të autorizuara jashtë vendit, duhet



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”
REKTORI**

të jenë njohur dhe njehsuar paraprakisht nga Ministria e Arsimit dhe Sportit në Shqipëri).

4. Dokumentacionin shoqërues përkatës original ose të noterizuar sipas plotësimit të kriterëve të shpallura etj.
5. Vërtetim punësimi nga punëdhënësi për eksperiencën e punës.
6. Vërtetim i gjendjes gjyqësore (Dëshmi penaliteti).
7. Raporti i aftësisë në punë.
8. Fotokopje e letërnjoftimit.
9. Librezë shëndetësore.
10. Leje nga punëdhënësi për mësimdhënie në UE.

Përveç konkurrimit me dosje aplikantët do t'i nënshtrohen *intervistës* në departament.

Dokumentacioni i kërkuar mund të dorëzohet në **rrugë postare** për periudhën **11.02.2026** deri më **20.02.2026**.

Adresa postare:

**Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”
Rruga “Ismail Zyma”
Aplikim në Fakultetin i Shkencave Mjekësore Teknike
Departamenti i Lëndëve Paraklinike
Elbasan**